



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**NR. 37, DATË 31 / 03 /2021**

**PËR MIRATIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE  
SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN  
E BASHKISË DURRËS**

Në mbështetje të pikës 1, gërma “a” dhe pika 2 e nenit 113 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 29, pika 3 dhe 4, nenit 33 pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 5 , neni 6, shkronja “b”, nenit 10, pika 3, nenit 13 , pika 1, shkronja “a”, nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja “dh”, dhe nenit 37, pika 1 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.8224 , datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar, neni 5 pika 1, nenit 10, nenit 12, nenit 23, nenit 29 dhe nenit 38, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, nenit 11, nenit 12 nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31 pika 12 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 ”Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, nenit 4, pika 1 shkronja “ç” të ligjit 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar , si dhe pika 7.7 shkronja “m” dhe “n” dhe pika 7.8 shkronja “f” të shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji, nenit 66, nenit 73 dhe nenit 76 të ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 230, datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore” dhe nenit 34 i “Rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, miratuar me vendim Nr. 447, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, Rregullores së Bashkisë dhe institucioneve në varësi, si dhe sipas relacionit hartuar nga administrata e Bashkisë Durrës, Zëvendëskryetari i Bashkisë Durrës i propozon Këshillit Bashkiak,

## VENDOSI :

1. Miratimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Durrës, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Dorina Milja**

*Alte porosi dhe me mungese;*  
*Almeda Rosk.*  
*Ch*

**U shpall sot më datë 01.04.2021**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHQIPËRI  
E SHQIPËRI



PËR

## CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS

Në mbështetje të pikës 1, gërma “a” dhe pika 2 e nenit 113 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 29, pika 3 dhe 4, nenit 33 pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 6, shkronja “b”, nenit 10, pika 3, nenit 13, pika 1, shkronja “a”, nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja “dh”, dhe nenit 37, pika 1 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar, neni 5 pika 1, nenit 10, nenit 12, nenit 23, nenit 29 dhe nenit 38, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, nenit 11, nenit 12, nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31 pika 12 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, ligjit nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, nenit 4, pika 1 shkronja “ç” të ligjit 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, si dhe pika 7.7 shkronja “m” dhe “n” dhe pika 7.8 shkronja “f” të shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji, nenit 66, nenit 73 dhe nenit 76 të ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 230, datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore” dhe nenit 34 i “Rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, miratuar me vendim Nr. 447, datë 16.06.2010 të

Këshillit të Ministrave, Rregullores së Bashkisë dhe institucioneve në varësi, si dhe sipas relacionit hartuar nga administrata e Bashkisë Durrës, Zëvendëskryetari i Bashkisë Durrës i propozon Këshillit Bashkiak,

## TË VENDOSË:

### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1.Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjellje, si dhe standarte të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Durrësit.

2.Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkelje të rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësinë dhe moralin publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.

3.Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimi i rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Durrësit, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që çenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

##### Neni 2 Përkufizime



Në këtë vendim, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **“Strukturë konstatuese”**, është çdo punonjës i strukturave të Bashkisë së Durrësit që ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësiqe që mbulon, i cili mund të jetë punonjës i Policisë Bashkiake, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Inspektoriatit Veterinar të Bashkisë, Drejtorisë së Shërbimeve, Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale apo çdo strukturë tjetër të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë.



2. **“Bashkëjetesa shoqërore”**, është tërësia e normave që përcaktojnë sjelljen/marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, nëpërmjet zbatimit të rregullit social, mbrojtjes së lirive dhe të drejtave individuale, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike-shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.

3. **“Funksion i Bashkisë Durrës”** është fusha e veprimtarisë , për të cilën Bashkia si njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencë ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo pjesërisht në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, sipas parashikimeve të ligjit 139/2015 i ndryshuar, përfshirë këtu lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse.

4. **“Hapësirë publike dhe hapësirë në bashkëpronësi”** , janë hapësira si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, shesh pushime shkallësh në pallate, rrugë kalime e mjedise të tjera në përdorim publik, përveçse përmes dokumentave të planifikimit, të parashikuar nga ligji.

5. **“Veprim”** , është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, apo sjellja e natyrës vetjake e çdo qytetari/individit, i cili kryhet gjatë ushimit të një veprimtarie, që licencohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mirë publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.

6. **“Licencë, leje, autorizim”**, është akti administrativ, që i njeh çdo subjekti apo individit të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, të drejtën të kryejë një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

7 **“Sanksionet administrative”** , janë akte administrative që lëshohen ndaj subjekteve nga strukturat konstatuese si rrjedhojë e shkeljes administrative të konstatuar.

### Neni 3 Parimet Bazë

1.Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet Bashkia e Durrësit dhe çdo strukturë e saj në veprimtarinë e tyre janë: Ligjshmëria, mosdiskriminimi, mbrojtja e të dhënave personale, paanësia dhe parimi i drejtësisë, mbrojtja dhe garantimi i interesit publik dhe jetës e shëndetit të qytetarëve, kontrolli dhe llogaridhënia.

2.Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi të caktuar në territorin e Bashkisë së Durrësit, përfshirë këtu miratimet apo autorizimet përkatëse, të cilat bëhen vetëm nëse :

a. Ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt nuk çënon apo mund të çënojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik në të mirë publike, objektiva sociale dhe çdo interes tjetër publik dhe qytetar të kësaj natyre.

### Neni 4 Misioni dhe detyrat e strukturës konstatuese

1.Struktura konstatuese, në varësi të bashkisë së Durrësit, në përmbushje të misionit dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve

argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike.

2.Çdo strukturë konstatuese, ka si detyrë të monitorojë, kontrollojë e marrë masat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për zbatimin e rregulloreve, urdhërave e udhëzimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari i Bashkisë, për probleme që lidhen me zbatimin e këtij vendimi apo përmbushjen e funksioneve të Bashkisë si një njësi e vetëqeverisjes vendore.

## **Neni 5**

### **Bashkëveprimi me strukturat e tjera**

Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, strukturat konstatuese të Bashkisë së Durrësit, sipas rastit dhe nevojës bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat dhe institucionet e tjera shtetërore.

## **KREU II**

### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

## **Neni 6**

### **Veprimtaria e lejuar në territorin e Bashkisë Durrës**

1.Në territorin e Bashkisë Durrës, përfshirë këtu hapësirat publike dhe ato private, lejohen të kryhen vetëm aktivitete dhe veprimtari që janë në përputhje me qëllimin e kryerjes së tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të përcaktuara dhe të rregulluara në akte administrative dhe normative të nxjerra nga Bashkia Durrës apo strukturat përgjegjëse të saj, nëpërmjet lëshimit të lejeve, autorizimeve dhe miratimeve përkatëse nga këto të fundit.

2.Çdo veprimtari apo aktivitet që ushtrohet në territorin e Bashkisë Durrës, duhet të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion.

3.Pavarësisht lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga entet publike shtetërore sipas fushës së kompetencave të tyre, çdo veprimtari apo aktivitet që zhvillohet apo synohet të zhvillohet në kundërshtim me këtë vendim, kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkia e Durrësit, dënohet në mënyrë administrative dhe merren masa deri në mbylljen e aktivitetit që ushtrohet.

## **Neni 7**

### **Zënia në kundërshtim me rregullat e hapësirës publike**

1.Ndalohet zënia e hapësirës publike dhe hapësirave mbi dhe nën to, në territorin e Bashkisë së Durrësit, qoftë edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj sendi apo objekti pa lejen apo autorizimin e Bashkisë apo strukturës përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.





2.Zënia e hapësirës publike, veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me normat detyruese dhe rregullat e miratuara nga Bashkia Durrës dhe legjislacioni në fuqi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas këtij vendimi, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.

3.Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Durrësit apo në rastet kur subjekti ushtron ose zhvillon aktivitetin në këto hapësira publike pa lejen përkatëse, strukturat konstatuese, veprojnë në përputhje me sanksionet administrative të parashikuara në nenin 15 të këtij vendimi.

4.Në rastin kur subjekti kundërvajtës rezulton, se është i padënuar në mënyrë administrative për shkeljen e konstatuar, atëherë struktura konstatuese vepron duke vendosur fillimisht dënimin administrativ “Paralajmërim me shkrim” , sipas nenit 15, pika 1, shkronja “a” e këtij vendimi

5.Në rastin kur, subjekti vijon të kryejë aktivitetin apo rezulton të jetë përsëritës i të njëjtës shkelje administrative, struktura konstatuese vendos dënimin me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Subjekti ambulant, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur struktura konstatuese e ka të pamundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka kryer kundërvajtjen administrative.

6.Në rastin e kundërvajtësit, identifikimi i të cilit nuk mund të vërtetohet me anë të dokumentave identifikuese, Policia Bashkiake liron hapësirën publike dhe e pasqyron në procesverbal bllokimin e mallit dhe ruajtjen e tij me një afat kohor prej 24 orësh nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes administrative. Procesverbali/akt konstatimi përpilohet dhe nënshkruhet konform pikës 1 të nenit 13 dhe pikës 1 e 2 të nenit 14 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

7.Me paraqitjen e dokumentave identifikues dhe kryerjen e procedurës përkatëse administrative, Policia Bashkiake nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit përkatës, bën zhblokimin dhe ja dorëzon mallin e bllokuar subjektit kundërvajtës.

8.Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 7 të këtij neni, Policia Bashkiake, me urdhër të Kryeinspektorit ngre një komision të përbërë prej jo më pak se tre punonjës për asgjësimin e mallit të bllokuar. Çdo veprim i komisionit dokumentohet me procesverbalin përkatës të asgjësimit.

9.E njëjta procedurë ndiqet nga Policia Bashkiake edhe në rastin kur kundërvajtësi është i identifikueshëm, por ushtron aktivitetin dhe zënen e hapësirës publike në mënyrë të paautorizuar nga strukturat përkatëse.

## Neni 8

### Kundërvajtjet administrative në fushën e sigurisë

Për atë që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e sigurisë publike, këto veprime:

- a. Zënia e trotuarëve, rrugës dhe rrugëkalimeve që pengojnë lëvizjen për qytetarët dhe automjetet, pa miratimin e strukturës përgjegjëse.
- b. Hedhja e objekteve dhe sendeve të forta, që pengojnë zhvillimin normal të veprimtarive sociale kulturore, kreative apo promovuese që zhvillohen në hapësirat publike.
- c. Përdorimi i banderolave dhe thirrjeve me përmbajtje fyese apo denigruese gjatë zhvillimit të aktiviteteve apo veprimtarive sportive, kulturore, fetare, artisitke, si dhe gjatë zhvillimit të tubimeve dhe manifestimeve.
- ç. Hyrja e personave në ambiente ku zhvillohen aktivitete publike, kreative apo promovuese, pa autorizimin e Bashkisë së Durrësit.
- d. Braktisja e automjeteve dhe sendeve të tjera në rrugë, mjedise publike apo ambiente të përbashkëta.
- e. Cënimi nëpërmjet bërjes së grafitëve ose shkrimeve, ndotjes me substanca të ndryshme apo gërvishtja e ndërtesave publike apo private, përveç rasteve kur kryhet në kuadër të veprimtarive artistike dhe me miratimin e strukturës përgjegjëse.
- f. Vendosja me ngjitje, kapsim apo çdo mënyrë tjetër, e afisheve apo posterave të ndryshme në ndërtesat private apo publike, pa miratimin e strukturës përgjegjëse.
- g. Kryerja e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin, pronën apo pronën e të tjerëve përmes vendosjes pa masa sigurie të vazove të luleve apo çdo send tjetër në parvazet e arrtareve, ballkoneve, në tarraca apo në çdo pjesë tjetër të mjedisve publike, të përbashkëta apo private.
- h. Përdorimi i lëndëve piroteknike apo fishekzjarrëve në çdo mënyrë që vë në rrezik shëndetin, jetën, pronën apo ambientin, në kundërshtim me legjislacionin për përdorimin e tyre.
- i. Lëvizja e automjeteve në orët dhe vendet e rezervuara për këmbësorët.
- j. Dëmtimi i mjedisve publike apo të përbashkëta, duke mos u ndalur vetëm në të: shkallët e fasadave të pallateve, lulishte, stola, shatërvanë, monumente, statuja dhe kënde lojrash.
- k. Vendosja e pengesave të çfarëdo lloji për kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes të automjeteve si dhe ndërtimi i objekteve perkujtimore përgjatë rrugës pa miratimin e organit përgjegjës publik.
- l. Kryerja e çfarëdo lloj veprimtarie në afërsi dhe pranë rrugëve, që rrezikon sigurinë rrugore, jashtë normave të sigurisë të përcaktuara nga Kodi Rrugor dhe pa miratimin e organit përgjegjës publik.
- m. Zënia e vendparkimeve publike dhe vendeve ku lejohet parkimi në hapësirat pranë blloqeve të banesave me automjete me qëllim ekspozimin/tregtimin e tyre apo qëllime të tjera biznesi.
- n. Qarkullimi me mjete motorrike, biçikleta në shëtitore, plazhe, parqe apo vende pushimi për qytetarët në orët e ndaluara sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkia e Durrësit dhe strukturat përgjegjëse të saj.



o. Si dhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, i parashikuar në akte nënligjore/normative të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

## Neni 9

### **Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës**

1. Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjediset publike nga muzika bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi.

b. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese, të çfarëdo lloji në ambjentet e përbashkëta të banimit.

c. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara nëpërmjet borive, muzikës së lartë të kasetofonave të makinave.

ç. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjedise publike e private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë apo pa miratimin e organit përgjegjës publik.

d. Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjrrit në zonat e banuara, përgjatë vijës bregdetare, lulishte apo parqe në vende të përcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturës përgjegjëse.

e. Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve lazer në ambjentet e hapura dhe të mbyllura publike.

f. Kryerja e garave të hipizmit në mjedise publike në qendrat urbane, parqe, lulishte në vende të pamiratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik.

g. Zhvillimi i lojrave me top apo lojrave të tjera që çenojnë sigurinë dhe qetësinë në zonat e pushuesve në hapësirat publike apo ambjentet e përbashkëta, përveç kur këto zhvillohen me leje të strukturës përgjegjëse apo në mjedise të posaçme të përcaktuara për këtë qëllim.

h. Si dhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

## Neni 10

### **Kundërvajtjet administrative kundër moralit publik**

1. Për atë që nuk përmbajnë veprë penale, përmbajnë kundërvajtje administrative në fushën e moralit publik, këto veprime:

a. Dalja zhveshur/nudo në mjediset publike.

b. Urinimi, defekimi apo të pështyri në mjediset publike.

c. Të bërtiturit me fjalë apo shprehje vulgare apo kryerja e veprimeve me gjeste vulgare në mjediset publike.

d. Veprimet apo sjelljet e çdo natyre që kanë për qëllim ngacmimin, fyerjen apo talljen ndaj njerëzve me afësi të kufizuara, të moshuarve dhe të pambrojturve.

e. Dehja në mjediset të hapura dhe në mjediset të mbyllura publike kur shoqërohet me veprime që krijojnë shqetësim për të tjerët.

f. Kërkimi i lëmoshës në mjediset publike dhe fshirja apo pastrimi i xhamave të makinave në semafor.

g. Si dhe çdo veprim tjetër apo mosveprim i cilësuar si kundërvajtje administrative parashikuar në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

## Neni 11

### Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit

1. Për atë që nuk përmbajnë veprë penale, përmbajnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime:

a. Djegia e mbetjeve urbane në kontenier, në vendgrumbullimin e mbetjeve (VGM-të), në territore private apo publike, brenda vijës së verdhë të qytetit.

b. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve nga shërbimi i pastrimit në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basenet ujore etj.

c. Dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme, mbetjeve të ndërtimit, në kontenierët apo vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane.

d. Dorëzimi ditor i mbetjeve urbane në një volum më të madh se  $\frac{1}{4}$  e volumit të kontenierit publik.

e. Dorëzimi në kontenier apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve si : I mbetjeve të lëngëta, i substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme apo kafshëve të ngordhura.

f. Dorëzimi i mbetjeve me aktivitet prodhimi, përpunimi, etj., si dhe mbetjeve të papranueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në kontenierët publik apo VGM-të.

g. Hedhja, derdhja në det e ujërave të zeza, në trotuare e mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit, dyqaneve etj.

h. Dorëzimi i mbetjeve urbane jashtë kontenierëve.



- i. Hedhja e mbetjeve të çastit, ambalazhet, mbetjeve të ngurta etj në hapësirat publike, të gjelbërta, plazhe.
- j. Mungesa e koshit të posaçëm pranë subjektit të shërbimit tregtar.
- k. Dorëzimi i pasistemuar, i papalosur apo i pambyllur në qese i mbetjeve tregtare, si dhe mos dorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia.
- l. Moskryerja e pastrimit, dëmtimit apo prishjes së cilësisë së rërës nga qytetarët/individët apo subjekte të ndryshëm publikë/privatë, lejimi i ndotjes ose mosmirëmbajtja e territoreve private të zbuluara, për të larguar në çdo mënyrë mbeturinat.
- m. Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrjes së mbetjeve të dorëzuara në kontenier etj nga persona të paautorizuar.
- n. Ndryshimi arbitrar i VGM-ve, i kontenierëve, i pikave të koshave dhe stacioneve të betonuara për hedhje dhe dorëzimin e mbeturinave të përcaktuara nga Bashkia.
- o. Hedhja, mbledhja dhe grumbullimi i materialeve, hekurishte apo çdo lloj mbetje dhe/ose e riciklueshme, në territore/hapësira publike apo dhe ambjente private që nuk janë miratuar nga Bashkia e Durrësit për këtë qëllim.
2. Fillimin e aktivitetit dhe ushtrimin e tij pa leje mjedisore, për të gjitha instalimet sipas Shtojcave 1 dhe 2 të ligjit Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar.
3. Në rastin kur ka ankesa nga banorët e komunitetit për ndotje akustike nga ushtrimi i veprimtarive të cilat nuk janë objekt i ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar për pajisjen me leje mjedisi, organet e pushtetit vendor në bazë të Ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, neni 8, pika 5, u kërkohet organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.
4. Shkelje të kryera në fushën e ndërtimit dhe të veprimeve në funksion të saj, të shkaktuara nga subjektet ndërtues/investitorë, për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:
- a. Ndotje e hapësirës publike nga gomat dhe pajisjet e automjeteve të tipeve dhe tonazheve të ndryshme, të cilat dalin nga kantieri i ndërtimit pa marrë masat për pastrimin e tyre.
- b. Ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit, nga inerte apo materiale të tjera ndërtimore.
- c. Krijimi i ndotjeve të hapësirave publike gjatë transportimit, për rastet kur kamionë të cilët transportojnë materiale ndërtimore, nuk janë të mbuluar.
- d. Si dhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative të parashikuara në akte ligjore/nënligjore/normative ose akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

## **Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike**

Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e infrastrukturës publike, këto veprime:

1. Ndërhyrje në rrjetin rrugor, si:

- a. Dëmtim, çarje, ndotje dhe bllokim rruge.
- b. Dëmtim, çarje, ndotje trotuari dhe dëmtim bordure.
- c. Dëmtim, bllokim pusete, kunete, vjellje kapaku/zgarë pusete.

2. Ndërhyrje në rrjetin elektrik rrugor dhe rrjetin e telefonisë, si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në kandelabrat apo rrjetin ajror.
- b. Dëmtim i shtyllave ndriçuese.
- c. Përdorimi i shtyllave si suport mbajtës/mbështetës për montimin e reklamave, kapjen e kabllave elektrik, telefonik, internetit etj.
- d. Dëmtimi i traseve kabllore e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje, si dhe shkuljen e shtyllave.

3. Ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion.
- b. Dëmtimi i pusetave.
- c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre, me ose pa leje.

4. Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbërta, si :

- a. Dëmtim i hapësirës publike dhe të gjelbërt, këputje, shkulje apo prerje pemësh, shkurre e bimë dekorative, etj në këto hapësira.
- b. Vendosje postersh reklamuese pa leje, në fasada, pemë, shtyllë, etj.
- c. Vendosje tabelash, pankartash, banderola pa leje.

Si dhe çdo veprim apo mos veprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet ligjore/nënligjore/normative ose akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

### **Neni 13**

**Kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambjentet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.**



1.Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambjentet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:

a. Të sigurojnë që në ambjentet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit apo kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin që:

-Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 metra.

-Të vendosin maska mbrojtëse për qentë e rracave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser.

-Të shmangin ndotjen e ambjenteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambjentin pas defekimit.

-Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit.

-Të vaksinojnë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinare, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit.

-Ndalohet kategorikisht, mbajtja në errësi të plotë, të përhershme dhe/ose lidhur gjatë gjithë kohës i kafshëve/shpendëve shtëpiakë të shoqërimit apo luksit.

-Personat të cilët, mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjestarët e tjerë të komunitetit, duke cënuar gëzimin e qetë të pronës së tyre.

-Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë apo shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit të tyre, është e ndaluar brenda të gjitha njësiteve të banimit ose pronës së përbashkët.

-Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtorale jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si : kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj,

b. Ndërsen kundër njëra-tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre.

2.Si dhe çdo veprim apo mosveprim tjetër cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet ligjore/nënligjore/normative ose akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

#### **Neni 14**

#### **Masat parandaluese për kundërvajtjet administrative**

Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve, mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.

## SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

### Neni 15

#### Sanksionet/Aktet administrative

- 1.Sanksionet/Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë :
  - a. Paralajmërim me shkrim/Akt konstatimi.
  - b. Proces Verbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.
- 2.Sanksioni “Paralajmërim me shkrim” është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkelje të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.
- 3.Në rast përsëritje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

### Neni 16

#### Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore

Masat e sanksionit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

- 1.Për kundërvajtjet në fushën e sigurisë dhe rregullave të hapësirës publike të parashikuara në nenin 7 dhe nenin 8, Drejtoria e Shërbimeve, dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake vendos gjobë nga 1.000(një mijë) deri 20.000 (njëzet mijë) lekë.
- 2.Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 9, Policia Bashkiake vendos gjobë nga 1.000(një mijë) deri 5.000 (pesë mijë) lekë.
- 3.Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 10, Policia Bashkiake vendos gjobë nga 2.000 (dy mijë) deri në 5.000 (pesë mijë) lekë.
- 4.Për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, do të vendosë gjobë:
  - a.Në masën 5.000 (pesë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 11 dhe për çdo rast të përsëritur kjo masë do të dyfishohet deri në vlerë maksimale prej 20.000 (njëzet mijë) lekë.



b. Në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 11.

c. Në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, për konstatimin e shkeljeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 11.

d. Në masën nga 5.000 (pesë mijë) - 10.000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimin e shkeljeve të parashikuara në pikën 4 të nenit 11.

5. Për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike, Drejtoria e Shërbimeve, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, vendos gjobë:

- Në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 12.

- Në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 12.

6. Për kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambjentet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, Inspektoriati Veterinar i Bashkisë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, do të vendosë gjobë :

a. Në masën 1.000 (një mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës një të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve.

b. Në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila do të jetë dyfishuar në rast të përsëritjes së shkeljes nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 4 dhe 5 të këtij neni, kur Policia Bashkiake konstaton në kryerje e sipër kundërvajtjen në fushën e infrastrukturës publike, vendos menjëherë dënimin me gjobë sipas parashikimeve të kësaj pike dhe në çdo rast njofton strukturat përkatëse në varësi të Bashkisë Durrës për llogaritjen e dëmit dhe shpërblimin e tij nga kundërvajtësi. Në këtë rast Policia Bashkiake vendos në dispozicion të strukturës përkatëse një kopje të procesverbalit të gjobës.

### **Neni 17**

#### **Shpërblimi i dëmit dhe përlllogaritja e tij**

1. Nëse struktura konstatare, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimit të tij.

2. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën në mënyrën e shpërblimit të dëmit.

3. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.

4. Përlllogaritja e dëmit të kryer sipas kësaj formule :  $DM = TSDM \times KRb$  ;  $TSDm =$  totali i sendeve të dëmtuara;  $KRb =$  kosto për kthimin në gjendjen e mëparshme të sendit të dëmtuar.

5. Strukturat përgjegjëse për shqyrtimin dhe përlllogaritjen e dëmit është struktura e cila ka pësuar dëm në pronën të cilën ajo administron.

#### Neni 18

### Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me sjelljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.

2. Nëse personi fizik ose personi juridik ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër ligjor/nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.

3. Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilën kundërvajtje, por jo më shumë se dyfishi i masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtjen më të rëndë.

4. Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.

#### Neni 19

### Rrethanat lehtësuese

1. Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

a. Kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer.

b. Kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen apo eliminuar dëmin e kryer.

c. Kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale e familjare.

d. Kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.

2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim administrativ me paralajmërim ose dënim administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.




## Neni 20 Rrethanat rënduese

1. Rëndojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

- a. Kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe pas kërkesës për të ndërprerë atë.
- b. Kundërvajtja është kryer nga më shumë se një individ apo grup individësh.
- c. Kundërvajtja është kryer gjatë një fatkeqësie natyrore ose rrethana të tjera të gjendjes së jashtëzakonshme.
- d. Kundërvajtja është kryer nën ndikimin e pijeve alkoolike, narkotike dhe/ose kushteve të rënduara psikologjike.

2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim me gjobë në një masë afër nivelit maksimal të masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtje.



## KOMPETENCAT DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE

### Neni 21

#### **Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore**

1. Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjithave kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si edhe të çdo shkeljeje tjetër të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak i Durrësit apo i Kryetarit të Bashkisë Durrës.

2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.

3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, struktura konstatuese e Bashkisë së Durrësit, nëse e sheh të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes apo shkeljes së konstatuar.

### Neni 22

#### **Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve**

1. Struktura konstatuese konstaton kundërvajtjet dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj.

2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dëmin administrativ që jepet dhe sipas rastit shpërblimin dhe përllogaritja e dëmit të shkaktuar. Procesverbali është akt administrativ.

3.Përpara nënshkrimit të procesverbalit të konstatimit dhe vendosjes së gjobës punonjësi konstatues i shpjegon kundërvajtësit shkeljen faktike të kryer, bazën ligjore dhe konsiderimin e saj si kundërvajtje administrative si dhe dënimin administrativ që zbatohet.Kundërvajtësit i jepet mundësia për të paraqitur, aty për aty, komentet dhe shpjegimet përkatëse.

4.Procesverbali, si rregull, hartohet në prani të kundërvajtësit. Ai nënshkruhet nga punonjësi konstatues, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka të tillë. Në rast kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, refuzon të nënshkruajë, nuk mundet të nënshkruajë apo refuzon të marrë procesverbalin, punonjësi konstatues bën një shënim të posaçëm në procesverbal dhe e vërteton këtë fakt nëpërmjet të paktën një dëshmitari.

5.Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbali njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

6.Dëshmitar, sipas pikës 4 të këtij neni, mund të jetë çdo person fizik me zotësi të plotë për të vepruar sipas përcaktimit të Kodit Civil, përfshirë këtu edhe një agjent tjetër konstatues.



### **Neni 23**

#### **Procesverbali dhe baza e të dhënave**

1.Modeli i procesverbalit për kundërvajtjet administrative dhe procesverbali për shpërblimin e dëmit miratohet nga kryetari i Bashkisë në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

2.Kryetari i Bashkisë, miraton rregullat për krijimin, administrimin e bazës së të dhënave për kundërvajtjet administrative, ku përfshihen, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesit në këtë bazë të dhënash.

### **Neni 24**

#### **Ankimi administrativ**

1.Kundër procesverbalit nëpërmjet të cilit është vendosur sanksioni administrativ më gjobë mund të paraqitet ankimi administrativ në Komisionin e Apelimit pranë Bashkisë Durrës, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak i Durrësit apo Kryetari i Bashkisë së Durrësit.

2.Në rast të lënies në fuqi të dënimit, gjoba paguhet në afatin e caktuar në vendimin e komisionit të apelimit, apo në mungesë të një parashtrimit të tillë në çastin kur vendimi hyn në fuqi.



**Neni 25**  
**Zbatimi Vullnetar**

1. Gjobat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve nga data kur gjoba bëhet e ekzekutueshme.
2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohet një kamatvonesë prej 2% (dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonese. Shuma totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.
3. Nëse gjoba paguhet vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data kur ai bëhet i ekzekutueshëm sipas Kodit të Procedurave Administrative, aplikohet një zbritje prej 20% e masës së gjobës.
4. Pagesa vullnetare e gjobës dhe/ose kamatëvonesa bëhet në llogarinë bankare të strukturës që ka vendosur sanksionin administrativ.

**Neni 26**


**Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv**

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, i vendosur nga strukturat konstatuese në zbatim të këtij vendimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i tyre kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në rast se nga aktet ligjore nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.
3. Të ardhurat nga gjobat dhe për kundërvajtjet dhe shpërblimin e dënimeve të parashikuara nga ky vendim, kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë së Durrësit.

**Neni 27**

**Procedurat e veprimit në rastet e kundërvajtjeve të tjera**

Kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik apo juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtjesit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.



**Neni 28**  
**Urdhërat dhe vendimet**

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Durrësit që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë urdhërat dhe vendimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi. Për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë së Durrësit miraton formularët përkatës që duhet të përdoren nga strukturat konstatuese të Bashkisë.

**Neni 29**  
**Strukturat që ngarkohen në zbatimin e vendimit**

Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Inspektoriat i Veterinar i Bashkisë, si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

**Neni 30**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**POLICIA BASHKIAKE**

**Kryeinspektor**

**Vasip Çopa**



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Ermal Lulo**







**DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**Drejtore**

**Luan Dajko**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE**

**Drejtore**

**Ardian Hiazaj**

**PËR DREJTORINË E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**Erma Lama**

**DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, SHËRBIMIT VETERINAR DHE  
EMERGJENCAVE CIVILE**

**Andri Cerri**

**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE KOMUNALE**

**Drejtore**

**Shpëtim Hidri**

**ZËVENDËSKRYETAR**

**Emiriana Sako**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 247/prot.  
5

Durrës, më 09.04. 2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.37 datë 31.03.2021 “Për miratimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

